

Për grupmosha
nga 12 deri 14 vjeç

Kuptojmë

Përmban:

Mësimi 2.1 /Padrejtësitë klimatike

Mësimi 2.2 /Luftërat klimatike dhe emigrimi mjedisor

Mësimi 2.3 /Të drejtat e fëmijëve dhe kriza klimatike

Veprimtari praktike /Bëj një hap përpara

Grupmosha 12-14 vjeç



Save the Children

Kuptojmë



Grupmosha 12-14 vjeç



Save the Children

Mësimi 2.1

PADREJTËSITË KLIMATIKE



Padrejtësitë klimatike



Kur flasim për ndryshime klimatike, mendojmë se ato kanë ndikim në mjedis, por jo tek njerëzit.

Përkundrazi, ndryshimet klimatike na prekin nga afër. Ato mund të destabilizojnë shoqëritë tona dhe të gjenerojnë konflikte, të varfërojnë kombe të tëra, të shkaktojnë emigrim dhe të përkeqësojnë pabarazitë mes grupeve shoqërore, brezave dhe gjinive. Keni dëgjuar ndonjëherë për **“drejtësinë klimatike”**?

“Drejtësia klimatike”

është një term dhe, më shumë se kaq, është një lëvizje që pranon se ndryshimet klimatike mund të kenë ndikime të ndryshme shoqërore ekonomike, të shëndetit publik dhe ndikime të tjera negative në popullatat më të pa favorizuara.



Klima e planetit tonë po ndryshon çdo ditë e më shumë. Ndryshimi i klimës është kërcënimi më i madh me të cilin komuniteti global duhet të përballet sot dhe në vitet e ardhshme. Por kjo gjë nuk i godet të gjithë në të njëjtën mënyrë. Prandaj drejtësia klimatike fillon me pranimin se grupe të ndryshme nuk preken njësoj nga ndryshimet klimatike

Çdo gjë është e ndërlidhur

Jo të gjitha ndikimet e ngrohjes globale janë të barabarta, as nuk janë të shpërndara në mënyrë të barabartë mes njerëzve dhe vendeve. Si ka mundësi?

Çdo gjë në planetin tonë është e ndërlidhur.

Jeta në Tokë bazohet në një ekuilibër të ndërlidhur dhe delikat dhe shënohet nga ritmi i parashikueshëm i stinëve. Ritmi i stinëve garanton një farë parashikueshmërie që ka lejuar qytetërimin njerëzor të strukturohet dhe zhvillohet.

Sigurisht, gjithmonë ekziston një kufi i paparashikueshëm i kushteve të motit, por ndryshimet klimatike po ndryshojnë kushtet mesatare të temperaturës dhe reshjeve në shumë pjesë të botës. Rritja e fenomeneve atmosferike ekstreme, të tilla si ciklonet, valët e të nxehtit ose përmbytjet komprometon aftësinë tonë për të parashikuar shiun apo periudhat e thatësisë.



Me çfarë pasojash?

Për shembull për bujqësinë.

Parashikueshmëria e natyrës ka lejuar fermerët e të gjithë planetit të mësojnë të njohin kohën e duhur për të mbjellë një kulturë të caktuar. Sigurisht, gjithmonë ka qenë e pamundur të dihej me siguri se çfarë dite do të fillonin shirat, por përvoja iu mësoi brezave të tërë fermerësh se, pavarësisht nga kufiri i pasigurisë, ka një stinë mbjelljesh dhe një stinë korrjesh.

Pa e ditur se kur dhe sa do të bjerë shi, është e pamundur të dish se kur dhe çfarë të mbjellësh. Ritmet dhe të kulturat e përdorura si gjithmonë, sot mund të pësojnë dëme të mëdha nga periudha të gjata të thatësirës ose nga reshjet e furishme dhe mund të mos jenë më të përshtatshme.

Por jo vetëm bujqësia dhe blegtoaria gjenden në vështirësi për bërë planifikime në një kontekst pasigurie. Për shembull, nëse do duhet të planifikojmë ndërtimin e një autostrade në



fund të luginës ose përgjatë një bregdeti. Si mund ta bëjmë këtë pa e ditur nëse lugina do të përmytet apo bregdeti do të goditet nga uraganet? Pa pasur një parashikim të ritmeve të natyrës, ulet aftësia jonë për të planifikuar dhe organizuar shoqërinë. Këtë ekuilibër bazë, ne e marrim si të mirëqenë, si ajri që thithim. Sepse nuk na është hequr kurrë dhe e kemi të vështirë të ndërrojmë gjësohem për rëndësinë e tij jetik dhe rreziqet që hasim nëse nuk ndalojmë ndryshimet klimatike.

Ekuilibri i natyrës është global në dy kuptime:




1

Ekuilibri i natyrës është global në kuptimin gjeografik. Disa ndryshime që ndodhin në anën tjetër të botës mund të kenë ndikim të drejtpërdrejtë edhe tek ne

2

Ekuilibri i natyrës është global në kuptimin që është i lidhur ngushtë me të gjitha fushat e tjera të jetës sonë, të cilat na garantojnë shëndet dhe mirëqenie.

Për të kuptuar rëndësinë e ndikimeve të ndryshimeve klimatike në aspektin e drejtësisë, barazisë, zhvillimit social-ekonomik dhe barazisë gjinore, duhet një qasje që shikon jo vetëm fenomenet individuale, por edhe marrëdhëniet komplekse mes tyre.



Në këtë skemë të thjeshtë, theksohen marrëdhëniet dinamike mes katër faktorëve: mjedisi, zhvillimi, paqja dhe stabiliteti, të drejtat e njeriut dhe ato shoqërore. Mes këtyre elementeve mund të vendosen rrethe vicioze.

Për të kuptuar rrethin vicioz, marrim si shembull sërish rastin e një fermeri. Një thatësirë e papritur (**problem mjedisor**) shkakton humbjen e të korrave. Pa këto të korra, fermeri nuk do të fitojë para nga shitja

e produkteve të tokës (**problem ekonomik ose zhvillimi**). Nëse fermeri është në një vend të pasur, problemi do të mbetet ekonomik. Në disa vende ekzistojnë instrumente mbështetëse (**p.sh. subvencionet**), që do ta lejojnë fermerin ta kapërcejë momentin e vështirësisë pa pasur pasojë dramatike në jetën e tij.

Ndërsa, nëse fermeri jeton në një vend të varfër, mungesa e të korrave do të kthehet shpejt në një problem të të drejtave të njeriut.

Humbja ekonomike mund ta detyrojë atë, për shembull, të mos jetë më në gjendje të përballojë studimet e fëmijëve të tij (**problem shoqëror**).

Varfërimi i papritur mund të çojë në krizë kohezionin social, ti shtyjë njerëzit të emigrojnë dhe të lehtësojë shfaqjen e konflikteve (**problem stabiliteti**). Kur ka paqëndrueshmëri dhe konflikt, mjedisi kalon lehtësisht në plan të dytë dhe shfrytëzohet së tepërmi dhe pa kujdes, duke çuar në një degradimin edhe më të madh të burimeve natyrore (**problem mjedisor**).

Por, megjithatë, marrëdhëniet mes katër faktorëve që përmendëm mund të shkaktojnë edhe mekanizma pozitivë.

Një fermer që ka pasur mundësinë të

trajnohet për kulturat më të qëndrueshme ndaj thatësisës dhe të mësojë si të përshtatet ndaj ndryshimeve klimatike, për shembull, përmes përdorimit të sistemeve të mbledhjes së ujit që do t'i lejojnë atij të vazhdojë të ujitë fushat edhe në rast vonese të zgjatur të shirave, do të jetë më e vështirë të pësojë humbje ekonomike, do të jetë i aftë të vazhdojë të mbrojë të drejtat e familjes së tij dhe të nisë një cikël konstruktiv të kujdesit për mjedisin dhe përparimin.

Kemi qëndrueshmëri sociale, ekonomike dhe mjedisore kur një mjedis i shëndetshëm bëhet një mundësi për rritje dhe zhvillim, gjë që motivon njerëzit të vazhdojnë ta mbrojnë. Natyra, zhvillimi, paqja, të drejtat mund dhe duhet të forcojnë njëra-tjetrën.



Padrejtësia klimatike: vendet e pasura dhe vendet e varfra

Ka grupe, njerëz dhe shtete që kanë qëndrueshmëri më të madhe, pra që kanë kapacitet Ka grupe, njerëz dhe shtete që kanë qëndrueshmëri më të madhe, pra që kanë kapacitet më të madh për tu përshtatur ndaj ndryshimeve, që lidhen me karakteristikat e mjedisit ku ndodhen ose me mundësitë materiale dhe ekonomike që kanë në dispozicion.

“Tashmë ndryshimi i klimës po ndodh dhe po ndodh për të gjithë ne. Asnjë vend apo komunitet nuk është imun dhe, si gjithmonë, të varfrit dhe të pambrojturit janë të parët që vuajnë dhe më të prekurit”, tha António Guterres, Sekretar i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

Pjesa më e madhe e shkarkimeve të gazrave serrë që po shkaktojnë krizën aktuale të klimës janë prodhuar, gjatë dekadave të fundit, nga vendet më të pasura dhe më të




industrializuara, të vendosura kryesisht në veri të planetit.

Megjithatë, gjithçka përzihet në atmosferë dhe planeti është vetëm një. Për pasojë, zonat më të varfra dhe më të cenueshme të botës, pavarësisht se kanë më pak përgjegjësi për sa i përket gazrave serrë të emetuara, janë të parat e që në mënyrë më të dhunshme vuajnë ndikimet e ndryshimeve klimatike.


Shkarkimet vjetore të CO2 sipas zonës gjeografike

A mund ta shihni Afrikën në këtë grafik?

Vendet e Afrikës Qendrore, për shembull, ku kriza të rënda hidrike po destabilizojnë rajone të tëra, përveçse kanë ndotur pak në të kaluarën, vazhdojnë të çlirojnë shumë pak gazra serrë në atmosferë, por janë në vijën e parë që duhet të përshtaten ndaj një planeti më të ngrohtë dhe më të paparashikueshëm.



Në këtë hartë shohim shpërndarjen e vendeve më të varfra në nivel global:




Çfarë vini re?

Zhvillimi industrial dhe rritja ekonomike e një pjese të botës ka pasur një kosto, në drejtim të shkarkimeve dhe dëmeve mjedisore, që vendet e tjera po e paguajnë sot. Të flasësh për drejtësi klimatike do të thotë ta njohësh këtë fakt dhe të ofrosh mbështetje për ato vende që janë në vijën e parë të frontit për të përballuar krizën klimatike.



Në këtë hartë shohim zonat e botës më të cenueshme ndaj ndryshimeve klimatike.



Padrejtësia klimatike: grupet dhe njerëzit më të cenueshëm



Edhe brenda të njëjtit vend ose të njëjtës zonë gjeografike, ka grupe më të cenueshme se të tjerët. Ndikimet e ndryshimeve klimatike kanë tendencë të theksojnë pabarazitë.

Komunitetet me të ardhura të ulëta, etni të ndryshme, njerëz me aftësi të kufizuara, persona të moshuar ose shumë të rinj, gra: subjektet më të brishta dhe me më pak burime janë më të prekurat nga ndikimet e ndryshimeve klimatike, si stuhitë dhe përmytjet e dhunshme, zjarret në rritje,

• nxehtësia e madhe, cilësia e dobët e ajrit, problemet e të pasurit ushqim dhe ujë. Personat e moshuar, personat me aftësi të kufizuara dhe personat me sëmundje kronike mund të kenë më shumë vështirësi për të jetuar gjatë periudhave të nxehtësisë intensive ose për t'u evakuar shpejt dhe në mënyrë të sigurt nga stuhitë ose zjarret e mëdha.



Njerëz me aftësi të kufizuara, persona të moshuar



Njerëz me të ardhura të kufizuara



Komunitetet e emigrantëve



Komunitete indigjene

Njerëzit me të ardhura të kufizuara që jetojnë në shtëpi të rrënuara apo të sajua janë të parët që humbasin gjithçka, në rast përmbytjesh apo stuhish të forta. Familjet me probleme ekonomike rrezikojnë të mos jenë në gjendje t'i rindërtojnë shtëpitë e tyre pas përmbytjeve apo zjarreve dhe as të paguajnë shpenzimet e mundshme mjekësore.

Për shkak të pengesave gjuhësore, **komunitetet e emigrantëve** mund ta kenë të vështirë të marrin informacion të menjëhershëm në lidhje me stuhitë e ardhshme, katastrofat e motit ose zjarret, ose të komunikojnë në mënyrë efektive me punonjësit e ndihmës së parë në rast urdhri evakuimi.

Disa **komunitete indigjene** po i shohin tashmë shtëpitë dhe mjetet e tyre të jetesës teksa humbasin për shkak të ngritjes së nivelit të detit apo thatësisë. Thatësira e zgjatur dhe përmbytjet mund të ndikojnë në furnizimin ose shpërndarjen e ushqimit, duke e bërë më të vështirë qasjen në ushqim të shëndetshëm dhe të përballueshëm.



Padrejtësia klimatike: brezat e ardhshëm

Të rinjtë e sotëm dhe brezat e ardhshëm do të përjetojnë ndikimet më të thella të ndryshimeve klimatike pak nga pak teksa do të përkeqësohen me kalimin e kohës, megjithëse nuk kanë pasur asnjë rol në shkaktimin e problemit.



Nga ndikimet e drejtpërdrejta negative në shëndet e deri tek ndërlikimet financiare, nevojat e shumta për përshtatjen dhe zbutjen në nivel lokal dhe global... e gjithë kjo rëndon kryesisht mbi supet e atyre që do të banojnë botën në dekadat e ardhshme.



Nga ndikimet e drejtpërdrejta negative në shëndet e deri tek ndërlikimet financiare, nevojat e shumta për përshtatjen dhe zbutjen në nivel lokal dhe global... e gjithë kjo rëndon kryesisht mbi supet e atyre që do të banojnë botën në dekadat e ardhshme. A është e drejtë kjo?

A është e drejtë kjo?

Drejt drejtësisë klimatike

Të flasësh për drejtësi klimatike do të thotë të kuptosh se ndryshimi i klimës është një çështje themelore etike dhe politike, jo vetëm mjedisore.

Një planet gjithnjë e më i ngrohtë rrezikon të bëhet një planet gjithnjë e më i padrejtë. Që kjo të mos ndodhë duhet një aleancë mes vendeve, brezave, komuniteteve, sektorëve të ndryshëm.

Këtë betejë nuk mund ta fitojmë të vetëm, por bashkimi i forcave në luftën kundër krizës klimatike mund të jetë një mundësi e madhe për drejtësi. Të mësojmë të zgjedhim, të mendojmë dhe të veprojmë si një komunitet i madh global që ndan të njëjtën shtëpi, duke kujtuar gjithmonë se jemi të gjithë të lidhur.

Ky është një revolucion që i hap rrugën drejtësisë dhe të drejtave.




Tri gjëra që duhet të mbani mend



- 1** Drejtësi mjedisore do të thotë të pranojmë se ndikimet e ndryshimeve klimatike janë më të menjëhershme dhe më të thella për ato vende dhe komunitete që janë më të varfra dhe për ata njerëz që janë më të brishtë dhe në kushte më të pa favorizuara, dhe se vendet më ndotëse kanë detyrimin t'i mbështesin.
- 2** Çdo gjë është e lidhur: natyra, zhvillimi, paqja, të drejtat mund dhe duhet të forcojnë njëra-tjetrën.
- 3** Ndryshimet klimatike janë një çështje etike, politike dhe për t'i trajtuar duhet një aleancë mes vendeve, brezave, komuniteteve, sektorëve.

Doni të testoni veten?

Provoni t'ju përgjigjeni pyetjeve në këtë test!



TEST 2.1

Padrejtësitë klimatike


1. Çfarë do të thotë “drejtësi klimatike”? Përpiqu të japësh një përkufizim.

2. Jepni të paktën dy shembuj të ndikimeve të ndryshimeve klimatike te njerëzit:

3. Në çfarë mënyre ndryshimet klimatike luhasin ekuilibrat e bujqësisë?

- Gazrat serrë nuk lejojnë rritjen e bimëve
- Variacionet në periudhat e reshjeve dhe thatësisë ndryshojnë ritmet dhe kulturat që fermerët kanë përdorur gjithmonë
- Fermerët nuk mund të parashikojnë më me siguri se kur do të fillojnë shirat

4. Si janë të lidhura me njëra-tjetrën këto elemente? Vendosni shigjetat për Si janë të lidhura me njëra-tjetrën.



5. Pse flitet për padrejtësi klimatike mes vendeve të pasura dhe të varfra?

- Sepse ndryshimet klimatike nuk godasin vendet e pasura por vetëm ato të varfra
- Për shkak se vendet më të varfra janë përgjegjëset kryesore për emetimet e gazrave serrë, por ndikimet e ndryshimeve klimatike prekin kryesisht vendet e pasura.
- Për shkak se vendet më të pasura janë përgjegjëset kryesore për emetimet e gazrave serrë, por ndikimet e ndryshimeve klimatike prekin kryesisht vendet e varfra

6. Përpiquni të renditni këto vende sipas cenueshmërisë dhe qendrueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike:

- | | | |
|---------------------------------|--|------------------------------------|
| <input type="checkbox"/> Çadi | <input type="checkbox"/> India | <input type="checkbox"/> Norvegjia |
| <input type="checkbox"/> Italia | <input type="checkbox"/> Shtetet e Bashkuara | <input type="checkbox"/> Kolumbia |

7. Cilat janë grupet dhe njerëzit më të cenueshëm?

- Personat e moshuar, personat me aftësi të kufizuara dhe personat e sëmurë
- Individët dhe familjet me probleme ekonomike
- Popujt indigjenë dhe emigrantët
- Të gjitha sa më sipër

8. Çfarë mund të bëjmë për të mos u gjendur në një planet gjithnjë e më të ngrohtë dhe më të padrejtë?

Mësimi 2.2

LUFTËRAT KLIMATIKE DHE EMIGRIMI MJEDISOR



Luftërat klimatike dhe emigrimi mjedisor

Ndryshimet klimatike mund të ndryshojnë ekuilibrat ekonomikë, socialë dhe mjedisorë, si dhe të ndikojnë në jetën e njerëzve në botë. Kjo ndodh më shpejt në një botë më shumë katastrofa, në shoqëri më të dobëta, të varfra dhe kryesisht të varura nga mjedisi natyror për mbijetesën e tyre.

Në dekadat e ardhshme, për shkak rritjes së ngrohjes globale, do të shohim një shtim të luftërave

SITUATË RASTI: Liqeni i Çadit

Për të shpjeguar lidhjen mes ndryshimeve klimatike dhe luftërave, le të marrim si shembull rastin e liqenit të Çadit, një pellg me ujë të ëmbël, në mes të shkretëtirës së Saharasë, në kufi mes Nigerisë, Kamerunit, Nigerit dhe Çadit.



Gjatë viteve '60, Liqeni i Çadit ishte trupi uhor i brendshëm i gjashti për nga madhësia në botë! Barinjtë dhe bujqit që jetonin në brigjet e tij bashkëjetonin në paqe. Peshkatarët, me piragot e vogla prej druri, kishin peshq me bollëk.



Gjatë dekadave të fundit, për shkak të periudhave të gjata me thatësi, shfrytëzimit të tepruar dhe rritjes së temperaturave, liqeni është tkurrur me 90%. Në vitin 1963, sipërfaqja e tij ishte 26,000 kilometra katrorë, ndërsa sot arrin 1,500 kilometra katrorë.

Liçeni i Çadit ndodhet në një nga vendet më të prekura në botë nga ndryshimet klimatike. Stinët e thata alturnohen me shira të rrëmbyeshëm të pa parë kurrë më parë. Prodhimi i peshkut është ulur me 60%. Biodiversiteti kërcënohet nga shkretëtirëzimi dhe shpyllëzimi i shfrenuar i lidhur me shfrytëzimin e tokës pjellore që rrethon liçenin. Ekosistemi po shembet.

Liçeni në vitin 1963

Për të shpjeguar lidhjen mes ndryshimeve klimatike dhe luftërave, le të marrim si shembull rastin e liçenit të Çadit, një pellg me ujë të ëmbël, në mes të shkretëtirës së Saharasë, në kufi mes Nigerisë, Kamerunit, Nigerit dhe Çadit.

Në vitin 2020, zona regjistroi reshjet më të mëdha të tridhjetë viteve të fundit. Përmbytjet e papritura detyruan mijëra njerëz të zhvendoseshin. Ata që kanë mbetur jetojnë në kushte varfërie, urie dhe kequshqyerje.

Liçeni sot



Bashkëjetesa paqësore mes grupeve etnike, peshkatarëve, bujqve dhe barinjve është shndërruar në një garë të ashpër për të kapur burimet e pakta të mbetura dhe shumë shpejt u shndërrua në një konflikt të armatosur.

Tragjedia mjedisore, shoqërore dhe ekonomike u përkeqësua më tej nga disa grupe të armatosura të Boko Haram, një organizatë terroriste e fundamentalistëve islamikë, që përfitoi nga uria, papunësia dhe varfëria për të mbledhur ndjekës dhe për t'u rritur.

Boko Haram ka një qëllim të qartë: të përmbysë institucionet qeveritare të dobëta dhe që pothuajse mungojnë për të marrë kontrollin politik dhe të armatosur të rajonit. Përse? Për të kapur burimet e pakta të zonës dhe mbi të gjitha për të kontrolluar bizneset e jashtëligjshme që po lulëzojnë në zonë dhe me të ardhura të larta.

Sot në rajonin e Liqenit të Çadit po ndodh një nga krizat humanitare më të rënda të kontinentit afrikan.

Degradimi i mjedisit dhe luftërat gjenerojnë “qarqe vicioze” në të cilat ndikimi i ndryshimit të klimës ushqen rreziqe dhe tensione, ndërsa konfliktet e armatosura që lindin nuk i japin mundësi komunitetit vendor dhe ndërkombëtar të trajtojnë rreziqet e pranishme në mënyrë efikase.

Historia e Liqenit të Çadit është vetëm një shembull.

Në të gjithë botën, po ndodhin konflikte gjithnjë e më komplekse dhe të qëndrueshme më shpesh në vendet më të prekura nga ndryshimet klimatike.


Ngadalësimi i krizës klimatike do të thotë gjithashtu të investosh në parandalimin e rrezikut ndaj sigurisë së njeriut.



SITUATË RASTI:

- Ishulli që nuk do të ekzistojë më

Shkojmë në anën tjetër të botës!



Keni dëgjuar ndonjëherë për Kiribatinë?

Aty jetojnë rreth 120,000 persona. Është një shtet ishullor i Oqeanisë. Në dekadat e ardhshme, i gjithë arkipelagu i Kiribatisë mund të përfundojë nën ujë për shkak të ngrohjes globale. Shumë prej banorëve të saj tashmë iu është dashur të emigrojnë diku gjetkë. Ata quhen **“emigrantë mjedisorë”** ose **“refugjatë klimaterikë”**.



Rasti i Bangladeshit: zhvendosje në masë drejt qyteteve

Bangladeshi, një nga vendet më të dendura për nga popullsia në botë dhe me një nivel të lartë të varfërisë, është një simbol tjetër i ndikimeve të ndryshimeve klimatike.

Bangladeshi ka 750 km vijë bregdetare dhe mbi 5 milionë banorë jetojnë në zonat tejet të cenueshme ndaj cikloneve dhe uraganeve. Më shumë se gjysma e popullsisë jeton deri 100 km nga bregu dhe 2/3 e Bangladeshit është më pak se 5 metra nga niveli i detit. Fushat pjellore të Gangut dhe Brahmaputras, të përshkuara nga mbi 700 lumenj, janë gjithmonë objekt përmbajtjes vjetore të erërave monsonë dhe cikloneve.

Gjatë viteve të fundit, rritja e **fenomeneve meteorologjike ekstreme**, më të shpeshta e më të dhunshme, po detyron miliona njerëz të lenë fshatrat e jugut për t'u transferuar në qytete, në kërkim të kushteve më të mira të jetesës. Çdo ditë, rreth **2,000 persona** zhvendosen nga fshatrat drejt kryeqytetit Daka. Për më tepër, një e treta e Bangladeshit mund të gjendet nën ujë brenda fundit të shekullit, nëse niveli i detit do të ngrihet me një metër.

Në këtë zonë të botës, ndryshimet klimatike nënkuptojnë infrastruktura dhe miliona banesa të shkatërruara, erozion i argjinaturave të lumenjve, humbje e të korrave, ujë i ndotur, përhapje e sëmundjeve, mungesë të ushqimit. Dhe jo vetëm kaq. Për shkak të ngritjes së nivelit të detit, uji do të infiltrohet gjithnjë e

më thellë në zonat bregdetare, duke rritur kripësinë e tokës dhe duke e bërë atë tokë jo pjellore.

Pjesa më e madhe e atyre që arrijnë në Daka në kërkim të një jete më të mirë përfundojnë në lagjet e varfra urbane në periferi të qytetit, ku jetojnë në kushte strehimi primitive. Këtu, si gjithmonë, të parët që privohen nga të drejtat dhe mundësitë e tyre janë gratë, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe fëmijët.

Megjithëse pjesa më e madhe e emigrimit në Bangladesh është e brendshme, lëvizjet ndërkufitare nuk duhet të nënvlerësohen. Bangladesh vazhdon të jetë ndër vendet kryesore të origjinës së emigrantëve që mbërrijnë në Evropë.



Luftërat klimatike dhe emigrimi mjedisor

Njeriu është zhvendosur gjithmonë. Arsyet e emigrimit janë të shumta.

Kemi faktorë të ashtuquajtur “nxitës” të emigrimit, si varfëria, mungesa e mundësive, të cilat i shtyjnë njerëzit të ikin jashtë shtetit të tyre. Kurse, faktorët “tërheqës” janë ata që tërheqin njerëzit drejt një vendi të ri, si mundësi më të mira jetese. Në varësi të motiveve të zhvendosjes, emigrimi mund të jetë vullnetar ose i detyruar.

Kemi **emigrim vullnetar** kur njerëzit zgjedhin të largohen me vullnetin e tyre të lirë dhe zakonisht kufijtë janë të hapur për këta lloj emigrantësh. Ata mund të kthehen në vendin e tyre kur të duan.

Kurse, **emigrantët e detyruar** janë të detyruar të largohen për shkak të luftës ose persekutimeve. Për ata që zakonisht nuk mund të kthehen në vendin e tyre të lindjes, liria dhe siguria janë aspektet e vetme që kanë rëndësi.



Emigrantët mjedisorë janë njerëz të shtrënguar të lenë shtëpitë e tyre për shkak të ndryshimeve të papritura (fatkeqësive natyrore) ose afatgjata të mjedisit të tyre lokal. Ndryshimet që komprometojnë mirëqenien e tyre ose sigurinë e mjeteve të jetesës: rritja e thatësisë, shkretëtirëzimi, ngritja e nivelit të detit dhe ndryshimi i modeleve meteorologjike stinore (p.sh. erërat musonet).

Emigrantët mjedisorë ose klimaterikë nuk bëjnë ende pjesë e asnjë përkufizimi ligjor të “refugjatis”. Kjo do të thotë se personat e detyruar ikin për shkak të ndryshimeve klimatike dhe nuk gëzojnë të njëjtën mbrojtje ligjore që iu ofrohet refugjatëve që ikin nga lufta dhe persekutimi. Emigrantët mjedisorë mund të ikin në një shtet tjetër, ose siç ndodh më shpesh, zhvendosen brenda vendit të tyre.





Siç e pamë, ngritja e nivelit të detit mund t'i detyrojë njerëzit të zhvendosen. Por ka edhe shumë mënyra të tjera në të cilat ndryshimet klimatike shkaktojnë emigrim, një fenomen ky shumë kompleks.



Ndryshimi i reshjeve të shiut, dendësia apo rralësia e tyre, prodhon përmbytje, thatësi, shkretëtirëzim, me pasoja në humbjen e të korrave dhe kullotave që shpesh i shtyn njerëzit ti braktisin zonat rurale dhe të emigrojnë në qytete në kërkim të kushteve më të mira të jetesës.



Ngritja e nivelit të detit mund t'i bëjë të pabanueshme breza të tëra toke bregdetare, edhe për shkak të kripëzimit të ujit dhe tokës.



Paqëndrueshmëria klimatike intensifikon rivalitetin mes popujve, shteteve, por edhe të shoqërive tregtare. Të gjithë duan të kapin sa më shumë burime të mundshme, duke rritur si pasojë emigrimet në masë.



Paqëndrueshmëria klimatike intensifikon rivalitetin mes popujve, shteteve, por edhe të shoqërive tregtare. Të gjithë duan të kapin sa më shumë burime të mundshme, duke rritur si pasojë emigrimet në masë.



Fatkeqësitë që lidhen me dukuritë meteorologjike ekstreme, si ciklonet ose përmbytjet.

Tri gjëra për t'u mbajtur mend



Ndryshimet klimatike janë shkaku kryesor i numrit në rritje të përplasjeve të armatosura në gjithë botën.s.

Uji është një nga burimet më të rëndësishme për jetën e të gjitha qenieve të gjalla, prandaj është një nga burimet që gjeneron më shumë zhvendosje..

Ndikimet e ndryshimeve klimatike mund të kontribuojnë në intensifikimin e fenomeneve të mëdha të emigrimit, si në shkallë lokale (brenda të njëjtit vend, sidomos nga fshati në qytete), ashtu edhe në shkallë globale (nga një shtet në tjetrin).

Burimet:


ASVIS, Jeta në Bangladesh: përplasje e përjetshme mes njeriut dhe kufijve të Tokës
Qendra e Studimeve Ndërkombëtare (2020), Ndryshimet klimatike janë një rrezik i ri për konflikt të armatosur: rasti i liqenit të Çadit

Fondacioni për drejtësi mjedisore, Zhvendosja klimaterike në Bangladesh
Qendra për Monitorimin e Zhvendosjeve të Brendshme (2020), Raporti global i zhvendosjeve të brendshme 2020

Lajme nga Universiteti Stanfordit (2019), Një studim i udhëhequr nga Universiteti i Stanfordit i cili heton sa shumë prekin ndryshimet klimatike rrezikun për përplasje të armatosur

Doni të testoni veten?

Provoni t'ju përgjigjeni pyetjeve në këtë test!



TEST 2.1

Luftërat klimatike dhe emigrimet mjedisor

1. Çfarë do të thotë “drejtësi klimatike”? Përpiqu të japësh një përkufizim.

- Ndryshimet klimatike dhe luftërat nuk janë të lidhura me njëra-tjetrën
- Ndryshimet klimatike mund të çojnë në rritje të luftërave
- Ndryshimet klimatike do të pakësojnë luftërat

2. Jepni të paktën dy shembuj të ndikimeve të ndryshimeve klimatike te njerëzit:

3. Sa lloje emigrimesh njihni? Zgjidhni të gjitha përgjigjet e vlefshme.

- Vullnetar
- Brenda të njëjtit vend
- I detyruar
- Mes vendeve të ndryshme

4. Emigrantët mjedisorë... (2 përgjigje të sakta)

- Ligjërisht njihen në të njëjtën mënyrë si refugjatët që ikin nga lufta dhe persekutimi
- Nuk përfshihen në asnjë nga përkufizimet ligjore të “refugjatit”
- Mund të ikin në një shtet tjetër, ose, më shpesh, të shpërngulen brenda vendit të tyre
- Falë zbutjes, ndryshimet klimatike do të pakësohen në dekadat e ardhshme

**5. Cilat fenomene që lidhen me ndryshimet klimatike mund të ndikojnë në migracion?
Jepni të paktën dy shembuj.**

**5. Cilat fenomene që lidhen me ndryshimet klimatike mund të ndikojnë në migracion?
Jepni të paktën dy shembuj.**

	Problem/e mjedisor/e	Ndikime social-ekonomike
Liçeni i Çadit		
Bangladesh		
Kiribati		

5. Përgjigju me (V) e vërtetë ose (G) e gabuar:

- Uji është një nga burimet që gjeneron më shumë shpërngulje
- Ngritja e nivelit të detit është arsyeja e vetme që i shtyn njerëzit të shpërngulen.
- Fatkeqësitë që lidhen me dukuri meteorologjike ekstreme, si ciklonet ose përmbytjet, mund të jenë një arsye për të emigruar

5. Çfarë po ndodh në Bangladesh? (2 përgjigje të sakta)

- Reshjet e dendura të shiut, përmbytjet dhe ngritja e nivelit të detit i shtyn njerëzit të largohen nga brigjet dhe fshatrat për t'u transferuar në qytet.
- Thatësira i shtyn njerëzit të largohen nga brigjet dhe fshatrat për t'u transferuar në qytet.
- Ndryshimet klimatike i shtyn njerëzit të largohen nga vendi i tyre për t'u transferuar në një shtet tjetër.

Mësimi 2.3

Të drejtat e fëmijëve dhe kriza klimatike



Të drejtat e fëmijëve dhe kriza klimatike

Siç pamë në mësimin e parë, klima është një sistem shumë kompleks, ku komponentët e ndryshëm, si atmosfera, hidrosfera, kriosfera, biosfera dhe litosfera, si dhe forcat vepruese veprojnë dhe ushqejnë njëra-tjetrën si një rrjet lidhjesh ku, kur një faktor ndryshon, shkakton një zinxhir të gjatë ndryshimesh, të cilat nga ana tjetër nxisin ndryshime të tjera, deri në ndryshimin e plotë të kushteve të fillimit.

Në të njëjtën mënyrë, edhe në nivelin shoqëror, ngrohja globale ndihmon në rritjen e rrethit vicioz të varfërisë, sepse efektet e saj prekin sidomos ata që kanë kontribuar më pak në këtë problem.

Ndryshimi i klimës krijon një hendek mes brezave: fëmijët dhe të rinjtë duhet të paguajnë faturën për një krizë që u është lënë nga brezat e mëparshëm.

Le të zbulojmë pse...



Ka tri arsye të ndërlidhura ngushtë pse fëmijët janë më të cenueshëm nga pasojat e ndryshimeve klimatike. Ja cilat janë ato:

1. Arsyet sociale

Ndikimet e ngrohjes globale ndikojnë në të ardhmen e afërt, veçanërisht tek ata që nuk janë përgjegjës për problemin: 50% e popullsisë më të varfra të botës është përgjegjës për vetëm 10% të shkarkimeve të CO2, ndërsa 10% më i pasur çliron 50%. Fatkeqësisht, familjet me më pak mundësi ekonomike shpesh jetojnë në zona më të ekspozuara ndaj ndikimeve të ngrohjes globale, duke rritur kështu efektet negative, si në domino. Sipas UNICEF-it, 160 milion fëmijë rriten në zonat me thatësi, një gjysmë miliard tjetër në zonat me rrezik të lartë përmbytje dhe stuhish.

2. Arsyet social-ekonomike

Rritja në familje pa burime për të përballuar fenomenin dhe për të zbutur efektet e tij, në shtëpi që shpesh janë të përkohshme dhe të rrënuara, me akses të dobët në shërbime themelore, ujë të pastër dhe ushqim të përshtatshëm, është një rrezik edhe më serioz në një epokë të karakterizuar nga intensifikimi i fenomeneve klimatike ekstreme.

2. Arsyet social-ekonomike

Rritja në familje pa burime për të përballuar fenomenin dhe për të zbutur efektet e tij, në shtëpi që shpesh janë të përkohshme dhe të rrënuara, me akses të dobët në shërbime themelore, ujë të pastër dhe ushqim të përshtatshëm, është një rrezik edhe më serioz në një epokë të karakterizuar nga intensifikimi i fenomeneve klimatike ekstreme.



Fëmijët paguajnë çmimin më të shtrenjtë!



Shumë fëmijë tashmë duhet të përballen me rreziqe klimatike si ciklonet, përmytjet dhe temperaturat ekstreme, të cilat ndikojnë në shanset e tyre për mbijetesë dhe mirëqenie.

Që në vitin 2011, UNICEF-i deklaroi se ndryshimet klimatike do të rrisin numrin e fëmijëve të prekur nga katastrofat mjedisore: nga rreth 66.5 milion në vit (1990) në 175 milion në vit (vlerësuar për dekadën e ardhshme). (UNICEF, 2011)

Ndryshimet klimatike ndikojnë në vdekshmërinë foshnjore, kryesisht në tri mënyra:

1.Përmes sëmundjeve: disa nga sëmundjet më të rrezikshme për fëmijët janë edhe ato më të ndikuara nga ndryshimet klimatike. Rritja e temperaturave është në fakt e lidhur me një rritje të shkallës së kequshqyerjes, kolerës, diarresë, etheve të malaries.

2.Rritja e pasigurisë ushqimore:

Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) hamendeson se për shkak të ndryshimeve klimatike, të cilat në kontekste të cënueshme mund të vështirësojnë qasjen në ushqim, do të ketë 10 milionë raste më shumë fëmijësh që vuajnë nga zhvillimi i vonuar për shkak të kequshqyerjes.

3.Ulja e disponueshmërisë së ujit dhe për pasojë e nivelit të higjienës:

me kushtet aktuale të rritjes së popullsisë dhe urbanizimit, me menaxhimin e papërshtatshëm të ujit dhe ngjarjet ekstreme të motit, deri në vitin 2040, në të gjithë botën, një e katërta e fëmijëve nën moshën 18 vjeç do të jetojnë në një zonë me stres të fortë hidrik. Nëse shkarkimet nuk pakësohen në mënyrë drastike, deri në vitin 2030 gati gjysma e popullsisë së botës do të jetojë në zona me stres të lartë hidrik, 75 deri në 250 milionë njerëz vetëm në Afrikë.



Ndikimet shëndetësore të dukurive klimatike ekstreme



Janë pikërisht qytetet ato që janë kryesisht përgjegjëse për ndryshimet klimatike: ato konsumojnë 75% të burimeve natyrore dhe janë përgjegjëse për më shumë se 70% të shkarkimeve të CO2. Qytetet janë “ishuj të vërtetë të nxehtësisë”, efektet e të cilave mbi shëndetin varen nga rritja e temperaturave, nga sa kohë mund të zgjasë vala e të nxehtit dhe nga faktorë të tjerë klimatikë, por edhe nga mënyra si janë ndërtuar. Kriza e klimës, në fakt, rrezikon të shfaqë ndikimet e saj më serioze në ato lagje, shpesh periferike,

104 F+ me pak gjelbërim, me tokë shumë të papërshkueshme nga uji, shumë ndërtesa dhe shumë makineri, ku ndoshta popullsia është e përqendruar me më pak mjete ekonomike dhe për këtë arsye më e cenueshme.

“Sot, gjithnjë e më shumë, vëmë re se padrejtësia mjedisore dhe sociale bashkëjetojnë në të njëjtin kontekst. Ata që jetojnë në periferi në kushte të pasigurta, shpesh jetojnë edhe në zona të privuara të qytetit, nga pikëpamja mjedisore, në kundërshtim me atë që ndodhte në të shkuarën, kur ata që ishin të varfër ende mund të jetonin në kontekste shumë të shëndetshme. Kurse sot, familjet me vështirësi më të mëdha social-ekonomike jetojnë në situata degradimi më të madh. Matja e performancës së territoreve të ndryshme në lidhje me të gjitha përmasat e qëndrueshmërisë, dhe në veçanti me vëmendjen ndaj varfërisë arsimore, është themelore. Kjo duhet të bëhet veçanërisht në nivel lokal, domethënë në vendet ku jetojnë njerëzit, duke i kushtuar vëmendje periferisë”

(nga një dokument i përgatitur nga Instituti i të Pafajshmëve dhe Save the Children).

Refugjatët e klimës

Sipas Qendrës së Monitorimit të Zhvendosjeve të Brendshme (IDMC), probabiliteti i emigrimit për shkaqe që lidhen me katastrofat natyrore është dyfishuar në krahasim me vitet 1970. Kërcënimet që lidhen me motin tashmë përbëjnë 87% të të gjitha shpërnguljeve prej katastrofave dhe ndikimit të ndryshimeve klimatike, dhe përqendrimi në rritje i popullsisë në zonat e ekspozuara ndaj stuhive dhe përmbytjeve do të thotë se ende ka njerëz që janë gjithnjë e më shumë në rrezik për t'u zhvendosur. Është e nevojshme të evidentohen më tej të gjithë faktorët që ndikojnë në emigracion, por klima është padyshim një faktor i rëndësishëm (shiko mësimin "Padrejtësitë klimatike").



Përshtatja me klimën që ndryshon



Sipas Qendrës së Monitorimit të Zhvendosjeve të Brendshme (IDMC), probabiliteti i emigrimit për shkaqe që lidhen me katastrofat natyrore është dyfishuar në krahasim me vitet 1970. Kërcënimet që lidhen me motin tashmë përbëjnë 87% të të gjitha shpërnguljeve prej katastrofave dhe ndikimit të ndryshimeve klimatike, dhe përqendrimi në rritje i popullsisë në zonat e ekspozuara ndaj stuhive dhe përmbytjeve do të thotë se ende ka njerëz që janë gjithnjë e më shumë në rrezik për t'u zhvendosur. Është e nevojshme të evidentohen më tej të gjithë faktorët që ndikojnë në emigracion, por klima është padyshim një faktor i rëndësishëm (shiko mësimin "Padrejtësitë klimatike").

E drejta për qëndrueshmëri mjedisore: çfarë duhet të bëjnë të rriturit dhe shoqëritë për të mbrojtur të ardhmen e të rinjve

Të shohësh sfidat e qëndrueshmërisë mjedisore dhe sociale nga pikëpamja e fëmijëve do të thotë të marrësh përgjegjësinë për t'u garantuar atyre qasje të barabartë në të drejta, duke luftuar pabarazitë, varfërinë, diskriminimin dhe disavantazhin shoqëror. Kriza mjedisore po fillon të jetë në qendër të vëmendjes në mbarë botën dhe për këtë çështje të rinjtë po pretendojnë rolin e tyre si protagonistë.



Është me rëndësi parësore:



- Të pranohet rëndësia e **edukimit mjedisor** duke nisur nga fëmijëria dhe nga një perspektivë lokale, sepse sjellja individuale dhe ato të lidhura me prodhimin duhet të ndryshojnë në mënyrë që të mbrohet e drejta e shëndetit e fëmijëve në vendin ku jetojnë;
- Të ofrohen vende dhe forma të strukturuar **ku të rinjtë të dëgjohen**, për t'iu dhënë zë protagonistit të tyre dhe për të nxitur qytetarinë aktive;
- Që **politika sociale** të ndërhyjë për vlerësuar shkaqet sociale ekonomike dhe kulturore të çekuilibrave aktualë;
- Të ndërhyhet në gjithçka që gjeneron çekuilibër dhe pabarazi mes brezave, pasi është e qartë se të miturit janë më të ekspozuarit ndaj rrezikut të varfërisë dhe se **varfëria arsimore** fillon nga fëmijëria e hershme;
- Të matet varfëria arsimore, që do të thotë të dihet saktësisht sa fëmijë kanë qasje në arsim dhe në çfarë mase, për të parë nëse politika po bën një punë të mirë për të promovuar një model të shoqërisë gjithëpërfshirëse për vajzat dhe djemtë, duke u garantuar atyre një nivel të lartë të cilësisë së jetës.

Varfëria është gjithashtu relative, e lidhur me izolimin dhe mungesën e shërbimeve dhe objekteve. Është e nevojshme të tregohet kujdes për rrjetet sociale dhe infrastrukturat. Kjo do të thotë që:

Familjet të mbështeten edhe me investime, një element thelbësor për të siguruar kushte mirëqenie të qëndrueshme nga pikëpamja e fëmijëve;

Të nxiten takimet mes brezave dhe familjeve, si p.sh. rrjeti i qendrave të këshillimit familjar dhe qendrave për familjet, projektet për promovimin e marrëdhënieve të fqinjësisë.



Ndryshimi fillon nga ti!

Burimet:

IDMC (2019), Zhvendosja nga katastrofat: një rishikim global (2008-2018)

Save the Children (2019), Koha e fëmijëve: Atlas i Fëmijëve në Rrezik 2019

UNICEF (2020), Vdekshmëria foshnjore ende në rënie në botë, por COVID kërcënon progresin

UNICEF (2011), Ndikimi i ndryshimeve klimatike te fëmijët: UNICEF në Konferencën e OKB-së në Durban

UNICEF: Çdo e drejtë për çdo fëmijë

“Të rinjtë kanë një vend të ligjshëm në tryezën vendimmarrëse. Janë agjentë të ndryshimeve që së bashku me ne ndërtojnë një të nesërme më të mirë. Kemi nevojë t’i dëgjojmë, por kjo nuk është e gjitha që duhet të bëjmë. Duhet t’i përfshijmë dhe ‘tu japim të rinjve mundësinë për t’u përfshirë në vendimet që prekin jetët e tyre”. (Jutta Urpilainen, Komisionere Evropiane për Partneritetet Ndërkombëtare)

“Të rinjtë kanë një vend të ligjshëm në tryezën vendimmarrëse. Janë agjentë të ndryshimeve që së bashku me ne ndërtojnë një të nesërme më të mirë. Kemi nevojë t’i dëgjojmë, por kjo nuk është e gjitha që duhet të bëjmë. Duhet t’i përfshijmë dhe ‘tu japim të rinjve mundësinë për t’u përfshirë në vendimet që prekin jetët e tyre”. (Jutta Urpilainen, Komisionere Evropiane për Partneritetet Ndërkombëtare)

“Të rinjtë kanë një vend të ligjshëm në tryezën vendimmarrëse. Janë agjentë të ndryshimeve që së bashku me ne ndërtojnë një të nesërme më të mirë. Kemi nevojë t’i dëgjojmë, por kjo nuk është e gjitha që duhet të bëjmë. Duhet t’i përfshijmë dhe ‘tu japim të rinjve mundësinë për t’u përfshirë në vendimet që prekin jetët e tyre”. (Jutta Urpilainen, Komisionere Evropiane për Partneritetet Ndërkombëtare)



VEPRIMTARI PRAKTIKE



BËJ NJË HAP PËRPARA

Ndryshimet klimatike nuk prekin të gjitha vendet dhe njerëzit në mënyrë të barabartë. Keni provuar ndonjëherë të vendosni veten në vendin e të tjerëve? Si do të ndryshonte jeta jote nëse do të kishe lindur në një pjesë tjetër të botës?



KU?

Në mjedis të hapur, në korridor ose në palestër.



SA KOHË ZGJAT?

Një orë mësimore (plus kërkim në shtëpi)



ÇFARË MË DUHET?

- Printo fletën e aneksit bashkëlidhur
- Gërshërë





SI BËHET?

- Printoni listën e personazheve bashkëlidhur dhe prisni copat individuale. Për suksesin e veprimtarisë është e rëndësishme që vetëm mësuesi të shohë përmbajtjen e aneksit. Mund të ndryshohen ose të shtohen personazhe, bazuar në temat e mbuluara edhe në mësimet e tjera të këtij seksioni (shiko “Padrejtësitë klimatike” dhe “Luftërat klimatike dhe emigrimet”).
- Caktojini çdo nxënësi nga një personazh dhe sigurohuni që të mos e zbulojë identitetin e tij të tjerëve. Të jepet kohë për të mbledhur ide dhe për të lejuar të gjithë të hyjnë në rol, duke imagjinuar jetën dhe zakonet e identitetit të caktuar. Në këtë fazë, mund t’i lejoni fëmijët të kryejnë një kërkim të shkurtër në internet mbi situatën shoqërore, ekonomike dhe politike të vendit ku jeton personazhi i tyre. Nëse është e nevojshme, mund t’iu jepet paraprakisht detyrë shtëpie një kërkim më i thelluar.
- Vendosini nxënësit në rresht dhe kërkoni të mbyllin sytë. Shpjegojuni se do të lexoni një sërë pyetjesh dhe situatash që nënkuptojnë mundësinë ose pamundësinë për të gëzuar një të drejtë, një mundësi, për të kryer një veprim ose për ta pësuar një veprim. Nxënësit nuk duhet t’u përgjigjen këtyre pyetjeve me zë të lartë, por mund të bëjnë një hap përpara për t’iu përgjigjur me “po” ose të qëndrojnë në vend në rast të një përgjigje negative. Kujdes: është e rëndësishme që të gjithë të mbajnë sytë mbyllur deri në fund të veprimtarisë. Në këtë mënyrë ata do të shmangin kushtëzimin nga njëri-tjetri.
- Lexoni pyetjet e mëposhtme dhe jepuni kohë të gjithëve të reflektojnë mbi situatën dhe të bëjnë një hap para nëse përgjigja është pohuese.
- Në fund të situatave të propozuara, nxënësit të hapin sytë dhe vëzhgoni pozicionet përfundimtare të marra. Zbuloni identitetet e personazheve dhe reflektoni mbi ndryshimin mes atyre që kanë ecur shumë përparuar (ka dhënë shpesh përgjigje “po” ndaj situatave) dhe atyre që kanë mbetur në pozicionin fillestar ose pak më përpara..

SI PËRFUNDIM

Pas vëzhgimit të vizatimeve të tu dy grupeve mund të krijoni postera, nga një për secilin tregim. Pastaj së bashku vëzhgojini dhe përpiquni t’iu jepni përgjigje këtyre pyetjeve me fëmijët:

- *Vini re dallime mes tregimeve të dy grupeve? Nëse po, cilat? Mendoni për dallimet mes dy vendeve në të cilat janë vendosur historitë.*
- *Si do të ndjeheshit në vend të fëmijëve që janë protagonistë të historive?*

PYETJE

1. Jeton në një shtëpi me ujë të rrjedhshëm.
2. Në kohën e lirë, mund të luash sportin që të pëlqen më shumë.
3. Mund të shkosh me pushime të paktën një herë në vit.
4. Mund të lëvizësh i vetëm/ e vetme në qytet pa frikë.
5. Mund t'i takosh shokët/ shoqet kur të duash.
6. Shkrija e akullnajave është një problem larg prej teje.
7. Shkon në shkollë dhe mund të vazhdosh studimet pa probleme nëse do.
8. Mund të hash darkë në restorant nëse dëshiron.
9. Në shtetin ku jeton, ke të drejtë të marrësh shërbimet e shëndetit publik.
10. Prindërit e tu kanë një punë dhe mund ta kalojnë kohën e lirë me ty.
11. Ngritja e nivelit të detit nuk e kërcënon vendin tënd.
12. Nuk je ndjerë kurrë i/e diskriminuar për shkak të origjinës tënde.
13. Jeton ose mund të vazhdosh të jetosh në vendin tënd të origjinës pa asnjë problem për aq kohë sa të duash.
14. Nëse je i/e sëmurë, ke mundësi të vizitohesh nga mjeku i familjes.
15. Mund të shprehësh mendimin tënd lirisht gjatë një diskutimi.
16. Një periudhë e gjatë thatësire nuk të shqetëson në veçanti.
17. Ndiheh i sigurt në shtëpinë tënde, kur ndodh një shqetësim meteorologjik.

SI PËRFUNDIM

Uluni në një rreth dhe ftojini nxënësit të reflektojnë duke përdorur këto pyetje si një pikënisje:

- Si u ndjetë gjatë veprimtqrisë Si u ndjetë teksa përpiqeshit të personifikonit persona të tjerë?
- Si u ndjetë kur bëtë hap para ose kur qëndruat në vend?
- Çfarë ndikimi kanë pabarazitë në karakterin tuaj? Po ndryshimet klimatike?
- Çfarë na tregon kjo lojë për shoqërinë ku jetojmë?

ANEKS

Personazhet e mëposhtme janë vetëm tregues dhe mund të modifikohen ose integrohen për të realizuar veprimtarinë

Je djali/vajza e fermerëve brazilianë.

Je një fëmijë që jeton në një zonë rurale në Kamerun (Afrikë).

Je djali/vajza e një menaxheri të një banke zvicerane.

Je një djalë/vajzë myslimane etiopiane që jeton në periferi të Romës.

Je një refugjat afgan në Itali.

Je djali/vajza e një peshkatari të vogël indian.

Je djali/vajza e një fermeri nga një vend i largët mes maleve të Nepalit.

Je djali/vajza e dy profesorëve universitarë në Gjermani.

Je djali/vajza e ambasadorit amerikan në Kanada.

Je djali/vajza e shtatë e një familje të varfër në Bangladesh.

Je një fëmijë uruguaian që jeton pranë një lumi.

Jeton në Florida me familjen tënde në një shtëpi të parafabrikuar.

Jeton në një fshat të vogël rural në Mozambik.


Jeton në Holandë me prindërit dhe dy vëllezërit e tu.

Je një refugjat/e siriane në Liban. Ke ikur vetëm me vëllain tënd të madh.

Je një refugjat/e siriane në Liban. Ke ikur vetëm me vëllain tënd të madh.


Jeton në një familje fermerësh të vegjël në Kinë, të detyruar të largohen nga rajoni i Mekongut të Sipërm për shkak të ndërtimit të një dige.

Je vetvetja.



Doni të testoni veten?

Provoni t'ju përgjigjeni pyetjeve në këtë test!



TEST 2.3

NDRYSHIMET KLIMATIKE LIDHEN EDHE ME TY

1. Çfarë rritet me ndryshimet klimatike?

- Temperatura e planetit.
- Varfëria.
- Të dyja sa më sipër.
- Asnjë nga sa më sipër.

2. Përse fëmijët janë më të pa mbrojtur kundër ndryshimeve klimatike (shënoni të gjitha ato që mendoni se janë të sakta)?

- Sepse nuk dinë se çfarë janë.
- Veçanërisht në vitet e para të jetës, fëmijët sëmuren më lehtë dhe shërohen më ngadalë.
- Sepse do të vuajnë pasojat më të rënda, por nuk janë përgjegjës për to.
- Asnjë nga sa më sipër.

3. Cilat janë tre nga motivet kryesore për të cilat mendohet se fëmijët janë më të cenueshëm ndaj ndryshimeve klimatike?

- Në Polin e Jugut.
- Në fshatra të vegjël.
- Në qytet.

4. Shpjegoni shkurtimisht çfarë nënkuptohet me “social-ekonomike” në lidhje me një nga motivet për të cilat mendohet se fëmijët janë më të brishtë ndaj pasojave të ndryshimeve klimatike:

5. Përgjigju me (V) e vërtetë ose (G) e gabuar:

- Parashikohet se ndryshimet klimatike do të rrisin numrin e fëmijëve të prekur nga katastrofat mjedisore: nga rreth 66.5 milion në vit (në vitin 1990) në 175 milion në vit
- Vetëm 10% e të gjitha zhvendosjeve për shkak të fatkeqësive natyrore janë për shkak të kërcënimeve që lidhen me kushtet klimatike
- Kriza klimatike ka të ngjarë të ketë efektet e saj më serioze në lagjet periferike, me pak gjelbërim, të qyteteve më të betonuara

6. Me cilin aspekt që lidhet me pasojat e ndryshimeve klimatike përkon ky përshkrim: “ndikimet e ngrohjes globale prekin në të ardhmen e afërt, mbi të gjithë, ata që nuk janë përgjegjës për problemin, në veçanti të varfrit, të rinjtë dhe fëmijët”?

- Ligjërisht njihen në të njëjtën mënyrë si refugjatët që ikin nga lufta dhe persekutimi
- Nuk përfshihen në asnjë nga përkufizimet ligjore të “refugjatit”
- Mund të ikin në një shtet tjetër, ose, më shpesh, të shpërngulen brenda vendit të tyre

7. Rendisni të paktën tre rreziqe që fëmijët po përballen tashmë për shkak të ndryshimeve klimatike:

- 1
- 2
- 3

8. Shpjegoni shkurtimisht pse familjet më të varfra vuajnë pasojat më të rënda të ndryshimeve klimatike:

Supported by:



Federal Ministry
for the Environment, Nature Conservation
and Nuclear Safety



European
Climate Initiative
EUKI



OIKOS



Save the Children

based on a decision of the German Bundestag

Ky botim u mundësua nga Save the Children në Shqipëri.

Save the Children është organizatë kryesuese në botë dhe e pavarur për fëmijë. Ne besojmë se çdo fëmijë meriton një të ardhme të mirë. Në botë dhe në Shqipëri, ne ndihmojmë fëmijët të kenë një fillim të mbarë në jetë, mundësi për të mësuar dhe mbrojtje ndaj cdo rreziku. Ne bëjmë më të mirën për fëmijët - çdo ditë dhe në kohë krize –për të sjellë ndryshime në jetën e tyre dhe të ardhmen e përbashkët.

Tiranë 2022

Ky material u botua në kuadër të projektit "Fëmijët Flasin", i mbështetur nga EUKI dhe i zbatuar nga Save the Children dhe Instituti Italian OIKOS.

@Të gjitha të drejtat të rezervuara. Përmbajtja e këtij botimi mund të përdoret apo kopjohet lirisht prej specialistëve të fushës, por jo për qëllime fitimprurëse, me kusht që çdo riprodhim të shoqërohet me njohjen e organizatave, të përmendura më lart, si burim. Këndvështrimet e autorëve të këtij botimi jo domosdoshmërisht pasqyrojnë pikëpamjet e Save the Children dhe Instituti Italian OIKOS.